

UDHËZIM
Nr. 1192, datë 13.2.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 179, DATË 11/01/2017 “PËR
DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT DHE PROCEDURAT E INSPEKTIMIT,
PEZULLIMIT DHE REVOKIMIT TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
SË AGJENCISË SË UDHËTIMIT DHE OPERATORIT TURISTIK”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 48 dhe 51 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, të nenit 16, pika 3 dhe nenit 19 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta të Këshillit të Ministrave”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 2, germa “a”, ndryshohet si më poshtë:

a) Diplomën universitare të ciklit të parë të studimeve në fushën e turizmit/shkencave ekonomike/gjeografisë/historisë/arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore/gjuhëve të huaja të lëshuar nga universitete brenda ose jashtë Shqipërisë ose diplomën master në shkencat ekonomike/turizëm ose diplomën e lëshuar nga IATA në fushën e turizmit ose diplomën e shkollës së mesme profesionale për turizëm ose çdo diplomë kualifikimi profesional në fushën e turizmit, për drejtuesin teknik ose përfaqësuesin ligjor (administratorin). Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga Ministria përgjegjëse për Arsimit. Dokumentet e lëshuara jashtë shtetit duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar.

2. Në pikën 4, germa “a”, ndryshohet si më poshtë:

a) Diplomën universitare të paktën të ciklit të parë të studimeve në turizmit/shkencave ekonomik /gjeografisë/historisë/arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore gjuhëve të huaja të lëshuar nga universitete brenda ose jashtë Shqipërisë ose diplomën master në shkencat ekonomike/turizëm ose diplomë e lëshuar nga IATA në fushën e turizmit, për drejtuesin teknik dhe përfaqësuesin ligjor (administratorin). Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma e lëshuar nga IATA në fushën e turizmit duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi